



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal 06/2024

I Mbajtur në takimin e VI-të të rregullt të KK-së me datën 20.06.2024, në sallën e Kuvendit në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtarës për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e VI-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të KK-së;
4. Propozim-Vendim për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027;
5. Pyetje dhe kërkesa dhe
6. Të ndryshme.

Pikat shtesë:

1. Propozim-Vendim për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033 të Komunës së Ferizajt;
2. Propozim-Vendim për emërtimin e dy anëtarëve të komisionit përzgjedhës nga Kuvendi i komunës për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave.
3. Propozim-Vendim për plotësim ndryshimin e vendimit nr. 40 të datës 30.05.2024 për Komisionin e Emërimit të rrugëve, Rrugicave dhe shesheve për kompletimin e sistemit të adresave komunale.

Kryesuesi i KK-së, Xhavit Zariqi - Pasi përshëndeti të pranishmit ju uroi mirëseardhje në mbledhjen e 6-të të rregullt dhe pastaj e propozoi këtë rend dite të lartëcekur, sa i përket konfirmimit të pjesëmarrjes unë nuk kam ndonjë informacion për ndonjë mungesë.

Sa i përket rendit të ditës, në KPF jemi dakorduar që të jenë edhe 3 pika shtesë të cilat janë të lartëcekura dhe pasi u hodhën në votim rendi i ditës kaloi me të gjitha votat për.

Sa i përket procesverbalit a ka ndokush ndonjë vërejtje apo diçka për të shtuar pyeti Kryesuesi, dhe pasi nuk pati e hodhi në votim dhe kaloi me të gjitha votat për.

Kryesuesi i KK-së, Xhavit Zariqi - Theksoi se sot para vetës kemi kornizën afatmesme buxhetore pra (KAB-in) për Vitin 2025-2027 i cili është një projektion se ka do të destionohen mjetet dhe është një lloj kornize e para miratimit final të buxhetit dhe për këtë arsye sot kemi edhe Kryetarin e Komunës së Ferizajt Agim Aliu të cilit ja japim fjalën për ta paraqitur këtë kornizë.

I nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës,

Drejtorë të drejtorive komunale,

Të respektuar anëtarë të Kuvendit,

Shoqëri civile, media,

Zonja dhe zotërinj!

Siç tashmë është e mirëditur, qershori është muaji kur nisim planifikimet e hershme buxhetore për vitet pasrendëse, me organizim të konsultës publike si nga ekzekutivi ashtu edhe nga legjislativi, për të vënë kornizat e qëndrueshme investimore, në kuadër të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027, dokument ky që kemi sot, për miratim në këtë seancë të Kuvendit të Komunës.

Korniza Afatmesme Buxhetore, paraqet një bazë mbi të cilën ndërtohet projektioni i së ardhmes, ngrihen e zhvillohen nisma me rëndësi publike, projekte që i japin kahe të reja zhvillimi - Ferizajt.

Qeverisja jonë, edhe në këtë dokument, ka pasqyruar vizionin e saj transformues, qasjen tonë reformuese e investive për çdo sektor e fushëveprimtari në kompetencën komunale. Ky dokument, është pra produkt i një mendësie qeverisëse transformuese dhe kërkesave qytetare të prezantuara në kontaktin tonë të drejtpërdrejt, për hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Ferizaj bën dallim mes qendrave tjera në gjithë vendin, sa i takon investimeve publike. Ferizaj, është shembulli i suksesit dhe transformimit rrënjësor, guximit, profesionalizmit e veprave publike madhore që sot e në të ardhmen, po merren e do të merren si referencë në gjithë vendin.

Ferizaj, nuk njeh pengesa, nuk njeh dorëzimin e ndalimin e punëve publike, për të mirën e qytetarëve.

Ferizaj ka rritur standardin e punëve publike në gjithë Republikën, e gjithashtu kemi rritur edhe pritshmëritë e ferizajasve. Ata presin zhvillimin në çdo ditë të punës sonë, ata presin transformimin për të cilën dhanë besimin, ata presin ecjen përpara, hapat e së cilës bashkë po i bëjmë.

Qyteti ynë dhe fshatrat e Ferizajt, kanë njohur për këto 7 vite të qeverisjes sonë, ndryshimin më thelbësor, transformimin më të plotë, përmirësimin më të ndjeshëm, përmes vargut të pafund të projekteve, veprave publike që ideuam e realizuam përgjatë këtyre viteve.

Ferizaj nuk është më i njëjtë, nga dhjetori i vitit 2017 e gjer më sot. Atë e thotë qartë çdo zë i ferizajasve e përtej qytetit tonë. Kjo është dëshmia më kuptimplote e rrugës sonë të drejt, duke përkthyer besimin e qytetarëve, në mirëqenie e zhvillim për të gjithë.

Tash, kur Ferizaj është në zenitet e transformimit të fizionomisë së tij në çdo pore të administrimit institucional, energjia jonë është e pashtershme, për të ofruar akoma më shumë, ide, vepra publike, projekte që kapin ritmet e zhvillimit dhe ecjes përpara që meriton Ferizaj e ferizajasit, andaj të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës, më lejoni të paraqes para jush, shkurtimisht, një përmbledhje të planifikimit tonë investiv e buxhetor të cilat kompozojnë Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027.

Në planifikimin buxhetor të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027 për vitin 2024 në kategorinë e investimeve kapitale janë buxhetuar 11,337,196.00€ kurse për vitet pasuese 2025, 2026, 2027, janë planifikuar 12,102,172.32€, 12,703,173.24€, përkatësisht 13,138,569.27€.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës!

Qeverisja jonë fokus bazë në projektet që kemi inicuar e planifikojmë për të ardhmen, ka të gjelbërtën. Orientimi ynë, është i qartë, përmes projekteve masive të gjelbërta, që kemi ideuar e tashmë me ritëm të lartë, po vazhdojmë punën për jetësimin e tyre.

Zgjerimi dhe rregullimi i Parkut të Lirisë po ndodh, për t'i dhënë ferizajasve, shumëfishin e hapësirave të reja të gjelbërta e vet qytetit një frymëmarrje të re.

Po kështu, Kodra e Sherretëve, është një tjetër storie e punës me përkushtim, për ta transformuar këtë hapësirë, në një ballkon të gjelbërt të qytetit, me infrastrukturën më moderne, me hapësirat e bollshme, për sport e rekreacion, unik si masiv i gjelbërt e i përplotësuar me infrastrukturë, në gjithë vendin.

Një park i ri i shtohet qytetit, edhe me zhvendosjen që do të ndodhë së shpejti në objektin e ri pothuajse të përfunduar të Kompanisë “Pastërtia”, duke i dhuruar ferizajasve, qindra metra më shumë, hapësirë të gjelbër pranë zonës qendër të qytetit.

Qeverisja jonë, tash e sa kohë po zbaton edhe projektin tjetër unik, atë të miniparqeve, sipas konceptit “Pocket park” ku deri më tani, dhjetëra hapësira publike, në qytet e fshatra, janë transformuar në ishuj të gjelbër, kënde rekreacioni e sheshe të gjelbërta në qendër të qytetit dhe fshatit.

Kjo nismë padyshim që do të zgjerohet e do të shtrihet për vitet pasrëndëse edhe në zona ku tashmë janë piketuar e idear planet konkrete për realizimin e tyre.

Në këtë pikëpamje, edhe për projektin e rregullimit të Tregut të Gjelbër, kemi përfunduar projektin detal e aktualisht jemi në fazën e shqyrtimit të mundësive për bashkëfinancim me donatorë, të kësaj veprë të kushtueshme e madhore, me rëndësi të veçantë për bashkëqytetarët tonë.

Po kështu, krahas masiveve të gjelbërta e transformimit infrastrukturor, kemi projektuar edhe rregullimin e shëtitores rreth shtratit të lumit nga ura e Dudit deri te Ura e Islamit, hapësirë e re kjo, në arteriet qarkulluese për qytetarët tonë.

Në fushën ku suksesi është sinonim i Ferizajt, infrastrukturën rrugore, kemi ideuar projekte të reja, po kështu edhe për të vijuar me ritme të larta, punën në projekte që tashmë kanë arritur në stade të larta progresi.

Vepra madhore infrastrukturore, që paraqet vizionin tonë më të qartë transformues – Nënkalimi për vetura dhe këmbësorë tek Stacioni Policor në Ferizaj, tashmë ka përfunduar gjysmën e punëve, për të vijuar suksesshëm e me dinamikë të shtuar edhe në gjysmën tjetër, drejt përfundimit.....

.....vepër kjo që i jep dimension krejt të ri zhvillimi Ferizajt në çdo cep të tij, duke qenë burimi nga ku shpërndahen kapilarët e zhvillimit ekonomik, qarkullimit rrugor, lidhshmërisë me qendrat ndër-urbane e dobitë e drejtpërdrejta që sjell kjo vepër për lëvizjen e ferizajasve.

Po kështu, qendrës së qytetit, i japim dimension të ri zhvillimi, me rikonstruktimin e plotë të rrugëve “12 Qershori” e “Tahir Sinani”.....

.....për të vijuar edhe me projektin madhor që kemi ideuar, atë të ndërtimit dhe rregullimit të sheshit nga rrethrotullimi i rrugës “Madeleine Albright” deri tek Teatri i Qytetit – mijëra metra hapësirë e re qarkulluese, shtojcë e sheshit qendror të qytetit, mundësi e jashtëzakonshme jo vetëm për qytetarët e familjet ferizajase, por edhe për biznesin.

Këtyre ditëve, kemi filluar edhe projektin për transformimin rrënjësor, të një prej rrugëve kryesore të qytetit, rrugën “Besim Rexhepi” e cila do të jetë, një rrugë model e qendrës së qytetit, me gjithë infrastrukturën e saj të kompletuar e moderne.

Në planin e infrastrukturës nëntokësore e rrugore në fshatra, qindra projekte tashmë po realizohen e përbëjnë edhe orientimin tonë investimor për të ardhmen, siç janë:

Asfaltimi i rrugëve të mbetura, rregullimi i trotuareve, investimet në infrastrukturën nëntokësore si në Neredime të Epërme, Bablak, Mirash, Tërrn, Muhoc, Prelez i Jerlive, Komogllavë, Zaskok, Balaj, Dremjak, Cërnillë, Surqinë, Gaçkë – Topojan, Varosh, Nikadin, Fshat i Vjetër, Rahovicë, Talinoc i Muhaxherëve, Greme, Sazli, Koshare, Lloshkobare, Kosinë, Pleshinë, Sojevë, Zllatar, Dardani, Rakaj, Doganaj, Softaj, Mirosalë, Gurëz e fshatra të tjera.....

.....pa lënë anash rrugicat e qytetit, investimet në infrastrukturën nëntokësore në qytet, të gjitha të paraqitura detajisht në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027, flasin qartë për qasjen që ka qeverisja jonë, për shpërndarjen e investimeve kapitale, barabarësisht, në gjithë territorin e Komunës sonë.

Tashmë, është gati edhe ndërtesa e re e Stacionit të Autobusëve në Ferizaj, një projekt me rëndësi të veçantë, i cili së shpejti do të funksionalizohet me kapacitetin e saj të plotë, e po kështu, kemi nisur tashmë procedurat, me synimin e qartë që ta realizojmë trafikun urban në Ferizaj.

Punët tona gjithashtu po vijojnë edhe në rregullimet e nevojshme në kuadër të Kompleksit të të Varrezave të Reja të Qytetit.

Me rëndësi të veçantë është edhe rikonstruktimi i rrugës Ferizaj – Pleshinë, përkatësisht rrugës “Naim Beka”, po kështu faza e fundit e rregullimit të rrugës “Cen Dugolli” e projekti për rregullimin e rrugës Varosh – Gurëz përgjatë hekurudhës si dhe mbikalimi për këmbësorë.

Në këtë kuadër, tashmë është e ditur, ne kemi nisur punimet edhe për zgjerimin e rrugës “Agim Ramadani” me synimin e shndërrimit të saj në bulevard, skaj objekteve shkollore e sportive në atë

zonë, shtoj këto edhe projektin për asfaltimin e rrugës pranë kazermës së FSK-së në Ferizaj, projekte këto që i japin zhvillim të ri gjithë zonës, me lidhshmërinë e dobënë e tyre të drejtpërdrejt.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit!

Në planet investimore të fushës së arsimit, qeverisja jonë, me fokusin e saj në përmirësimin e infrastrukturës shkollore, duke qenë parakusht për cilësinë në arsim, kemi nisur punimet për ndërtimin e godinave të reja shkollore, si për objektin e Shkollës së Mesme në Ferizaj, objektet e reja shkollore në Neredime, në Tërrn.....

.....e po kështu, me orientimin tonë të plotë për godina të reja shkollore në Manastirc, përfundimin e aneksit të shkollës fillore – ish “Dr. Shaban Hashani” si dhe linjën e veçantë buxhetore për ndërtimin e anekseve e renovimin e shkollave dhe sallave sportive.

Në këtë kuadër, përveç sallave të sportit që tashmë kemi ndërtuar si në Gaçkë, Balaj, Fshat të Vjetër, tek shkolla “Astrit Bytyçi” e të tjera, kemi ideuar edhe ndërtimin e Sallës së Sportit në shkollën “Ganimete Tërbeshi”, fushën e sportit në Surqinë e Tërrn, investime këto mundësi për shëndetin e të rinjve, mundësi e shtuar kjo edhe për sportistët e klubet sportive.

Në fushën e arsimit, vlen të theksohet se Ferizaj është komuna e vetme në gjithë vendin, lidere në gjithë Republikën, sa i përket mbështetjes së studentëve me bursë komunale, ku vetëm për këtë vit, kemi mbështetur mbi 1000 studentë me bursë komunale, e po kështu, për të katërtin vit me radhë, kemi ndarë bursë për të gjithë studentët aplikues.

Në fushën e bujqësisë, Ferizaj po ashtu shquhet në mesin e komunave tjera, ku miliona euro mbështetje kemi ndarë për bujqit e fermerët, përmes skemave të subvencionimit me pajisje, mekanizëm bujqësor e të subvencionimit të kulturave bujqësore.

Në pikëpamje të investimeve kapitale në këtë fushë, kemi nisur projekte domethënëse e me rëndësi të posaçme për bujqit e fermerët ferizajas, si projekti për ndërtimin e silloseve për ruajtjen e grurit, ndërtimi i Qendrës së Panairëve – Hipodromit që paraqet edhe një atraksion turistik.....

..... gjithashtu rregullimi i tregut të kafshëve dhe strehimores për qentë endacak e po kështu do të vazhdojmë edhe më projekte të natyrës infrastrukturore për lehtësimin e veprimtarisë së bujqve e fermerëve siç është projekti për rregullimin e rrugëve të arave me zhavor,

hapja e kanaleve kulluese për kullimin e tokave bujqësore, si dhe rregullimin e kanaleve ujitëse për fshatrat Neredime e Balaj.

Një segment tjetër i rëndësishëm në qeverisjen tonë është ai i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, për të cilën në projeksionin tonë investimor, parashohim një varg projektsh të rëndësishme kapitale për infrastrukturën shëndetësore e mirëqenien sociale.

Kështu, tashmë janë në stad të avancuar punimet për objektin e ri të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, bashkëfinancim me Ministrinë e Shëndetësisë, po kështu në stad të avancuar janë punimet edhe për Qendrën e Mjekësisë Familjare nr. 2 në rrugën “Remzi Hoxha” si dhe për Qendrën e Mjekësisë Familjare në Prelez të Muhaxherëve.

Këto ditë, kemi ndarë lokacionin për ndërtimin edhe të Qendrës së Mjekësisë Familjare në Koshare, me qasjen e ofrimit më afër të shërbimeve shëndetësore për bashkëqytetarët tonë në këtë zonë, gjersa në projeksionet tona për të ardhmen janë edhe projekti për ndërtimin e Shtëpisë së Pensionistëve si dhe Qendrës Rehabilituese për përdoruesit e substancave narkotike.

Në këtë fushë, parashohim edhe krijimin e modernizimin e infrastrukturës konkretizuese shëndetësore, si përmes blerjes së dy autoambulancave, karrigeve stomatologjike, laboratorëve etj.

Në këtë mes, vlen të theksohet edhe mbështetja e vazhdueshme që bëjmë përmes Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, për bashkëqytetarët tonë me sëmundje të rënda, familjet strehuese, Përsone me nevojë të veçanta, nënat vetushqyese, të pastrehët e familjet me kushte të rënda ekonomike, të cilët i kemi mbështetur vazhdueshëm me të gjithë kapacitetin tonë në dispozicion për këtë fushë.

Në sferën e zhvillimit ekonomik dhe turizmit, Ferizaj është komunë lidere sa i përket mbështetjes, veçanërisht për bizneset e udhëhequra nga gratë, ku siç është dëshmuar edhe në vitin paraprak, 100% e fondit të dedikuar për mbështetje të bizneseve, e kemi ndarë për bizneset e udhëhequra nga gratë, vendimmarrje kjo që po vazhdon edhe këtë vit, me zgjerimin e skemës mbështetëse edhe për mikrobizneset, start-upet e po ashtu bizneset e udhëhequra nga gratë.

Tashmë, përmes Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, kemi filluar rregullimin e infrastrukturës në zonën turistike Neredime-Jezerc, investimin në rregullimin e shtigjeve të ecjes e ngjitjeve malore, për të vijuar edhe me projeksionet tona për rregullimet në Ujëvarën e fshatit

Pleshinë, ndërtimin e murit alpin në Jezerc, rregullimin e zonës turistike rreth Kalasë së Jezercit, si dhe ndërtimin e shtigjeve të ecjes për Përsinat e verbër në Neredime – Jezerc.

Në sferën e shërbimeve publike dhe emergjencave, angazhimi ynë i shtuar do të jetë në vepra kapitale që lehtësojnë e mundësojnë shërbime më të shpejta e cilësore për qytetarët. Kjo, përmes projekteve si ai për renovimin e brendshëm të objektit të Brigadës së Zjarrfikësve në Ferizaj, ndërtimin e dy objekteve për nevoja të Komunës, një në fshatin Gurëz dhe një në Ferizaj, ndërtimi i infrastrukturës për vendosjen e monitorëve dinamik në trafik.....

.....rregullimin e infrastrukturës për vendosjen e hidrantëve në Ferizaj, Greme e Komogllavë, kontejnerëve mbitokësor dhe komposterëve, rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe kanaleve ujore, rregullimi i infrastrukturës për Përsina me nevoja të veçanta e po kështu edhe ndërtimi i vend-ndaljeve, pritoreve të autobusëve si dhe rregullimi i udhëkryqeve rrugore.

Në këtë kuadër, do të vazhdojmë me punë edhe në eliminimin e deponive ilegale të mbeturinave, shtimin e rrjetit të ndriçimit publik, riparimet e infrastrukturës nëntokësore, ujësjellës e kanalizim si dhe hapja e rrugëve të reja me zhavor e po kështu edhe riparimi i rrugëve, trotuareve me asfalt dhe kubëza.

Në sferën e kulturës, rinisë dhe sportit, përveç mbështetjes për institucionet kulturore, ngjarjet identitare kulturore në Ferizaj, skenën e pavarur të artit, klubet sportive e sportistët, të rinjtë, kemi shtuar kapacitetet në kuptim të hapësirave të reja sportive siç theksova më lartë.....

.....porse me këtë qasje do të vazhdojmë edhe në projektin në renovimin e brendshëm të Palestrës së Sporteve “Bill Clinton” në Ferizaj, ndërtimin e fushave për futboll të madh në Sazli, Saraishtë dhe Dardani, ndërtimin e fushave sportive në fshatra e qytet, rregullimin e tribunave në stadiumin e fshatit Tërrn.....

.....si dhe investimin në vepra artistike skulpturale e përkujtuese, siç është projekti për ndërtimin e Obeliskut për Kuvendin e Ferizajt të vitit 1908, vepra këto që do t’i mbeten të ardhmes si reflektim i të kaluarës sonë historike.

Zonja dhe zotërinj!

Anëtarë të Kuvendit të Komunës!

Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027, me projekte e nisma të shumta, është pikënisja buxhetore, plani ynë i së ardhmes për Ferizajn që meriton të jetë edhe më i zhvilluar, edhe më shërbyes edhe më i begatë në çdo sferë shoqërore.

Andaj duke ju falënderuar për mbështetjen që i keni dhënë në këtë Kuvend këtij synimi tonë, përpjekjes për më të mirën për Ferizajn e ferizajasit, jam besimplotë se edhe dokumenti që sot keni para vetes, do të marr mbështetjen tuaj të plotë për të vijuar hapin tonë, ritmin e pandalshëm për të bërë më të zhvilluar Ferizajn tonë.

Ju faleminderit!

Kryesuesi i KK-së, Xhavit Zariqi - Pasi falenderoi kryetarin për këtë kornizë afatmesme buxhetore theksoi se nga ky moment e hap debatin për KAB-in dhe fjalën ia kaloi Brahim Osmanit
- Faleminderit i nderuari Kryesues;

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal;

Përfaqësues të ekzekutivit;

Media dhe shoqëri civile;

Të dashur qytetarë të Komunës së Ferizajt;

Sot, jemi mbledhur për të diskutuar Kornizën Afatmesme Buxhetore, dokument që do të duhej ta reflektonte vizionin dhe përkushtimin tonë për zhvillimin e Ferizajt.

Por për fat të keq, ky dokument është vetëm pasqyrë e qartë e dështimeve që si shabllon përcjelllet vit pas viti që tregon mungesën e përkushtimit të qeverisjes aktuale ndaj nevojave reale të qytetarëve të Ferizajt.

Pra, ashtu si edhe viteve të kaluara, kemi përsëritje të projekteve dhe shumave të parave që figurojnë vetëm si numra për ta kryer këtë obligim, e jo për të planifikuar vërtetë projekte dhe për t'i realizuar ato.

Për ta parë më saktë pse qeverisja as vetë nuk e trajton seriozisht këtë dokument mjafton ta shohim se si ka vepruar në vitet e kaluara.

Njëjtë edhe si në këtë vit, kanë shkruar tituj të projekteve dhe i kanë shkruar çmimet e parave për to, mirëpo asnjëherë nuk u janë përmbajtur këtyre planeve.

Prandaj edhe jemi në situatën ku projekte të shumta që është dashur të jenë që një kohë të gjatë të realizuara, vetëm barten nga KAB-i në KAB dhe në fund ngelin pa asnjë cent për shkak të projekteve të tjera ku mundësitë për të vjedhur janë më të mëdha.

Kjo është për keqardhje dhe këtë e shohim edhe në këtë Kornizë Afatmesme.

E para, le të flasim për investimet dhe projektet e parapara në Drejtorinë për Shërbime Publike.

Zonja dhe zotërinj, transparenca dhe llogaridhënia këtu janë të domosdoshme. Në Kornizën Afatmesme Buxhetore janë parashikuar shuma të mëdha për projekte infrastrukturore, por mungojnë informacionet themelore për mënyrën se si këto fonde do të përdoren.

Për riparimin e rrugëve dhe trotuareve me asfalt dhe kubëza janë paraparë 1 milion e 450 mijë euro. Megjithatë, nuk ka asnjë shpjegim minimal se ku dhe si do të investohen këto para. Çfarë rrugësh do të riparohen? Cilat trotuare do të përmirësohen? Këto janë pyetje që Drejtori duhet t'iu përgjigjet.

Gjithashtu, për shtruarje të rrugëve me zhavor dhe hapje të rrugëve të reja janë parashikuar 1 milion euro. Sërish, nuk ka asnjë informacion specifik se cilat rrugë do të shtrihen me zhavor apo ku do të hapen rrugë të reja. Kjo mungesë e transparencës është e papranueshme.

Për riparim dhe zgjerim të ndriçimit publik janë alokuar 1 milion e 450 mijë euro. Por, nuk ka asnjë elaborim më të vogël për këtë investim. Ku do të vendosen dritat e reja? Cilët zona do të përfitojnë nga ky projekt? Këto detaje mungojnë tërësisht.

Për riparim të kanalizimit dhe ujësjellësit janë paraparë 1 milion e 450 mijë euro pa asnjë sqarim. A nuk duhet të dimë se cilat lagje do të përfitojnë nga ky projekt? Cilat sisteme janë në nevojë të riparimit urgjent?

Në total pra vetëm nga këto projekte kemi 5 milion e 350 mijë euro të paspecifikuara, për të cilat nuk dihet ku përfundojnë. Këto para vetëm janë shkruar në këtë Kornizë Afatmesme Buxhetore, por nuk dimë se ku dhe si do të investohen. Është detyrimi ynë të kërkojmë llogaridhënie dhe transparençë për mënyrën se si shpenzohen paratë e qytetarëve. Vetëm kështu mund të sigurojmë që këto fonde të përdoren në mënyrë efektive dhe në dobi të komunitetit.

I njëjti avaz vazhdon me Drejtorinë e Infrastrukturës.

Në pjesëmarrje me projekte me donatorë janë paraparë 200 mijë euro. Por ku janë projektet e mëhershme që kanë qenë të parapara si bashkë-investime me donatorët?

Për “Stacionin e autobusëve” janë paraparë të ndahen edhe 400 mijë euro të tjera. Për këtë stacion po trumbetohet se është përfunduar e edhe nëse është përfunduar, përsëri është tejkaluar afati i përfundimit. Si është e mundur që këtu parashihet të ketë punime edhe pas dy vitesh?

Për pjesëmarrje në projekte me donatorë për ujësjellësin në Sojevë dhe Dardani janë parashikuar 950 mijë euro. Edhe më herët ka pasur planifikime të tilla, por ujësjellësi për këto fshatra ende nuk ekziston. Është e papranueshme që këto projekte të mbeten vetëm në letër dhe të figurojnë vetëm të shpenzuar fleta, sepse projektet tashmë po shihet se nuk përfundohen.

Është e turpshme se si keni planifikuar të ndani 520 mijë euro për rrugën me trotuar në fshatin Cërnillë dhe Surqinë, kur ju vetë për inate politike dhe Përsonele keni sabotuar ndërtimin e kësaj rruge për tre vjet rresht. Por më nuk do të mund të sabotoni, sepse këtë rrugë do ta përfundojë Qeveria e Republikës së Kosovës, dhe nuk keni pse të kamufloni sikur po brengoseni.

Për rrugët Talinoc i M-Rahovicë për vitin e ardhshëm keni paraparë vetëm 70 mijë euro. Së pari, duke ju njohur si veproni, kam dyshime se a do të mbesin këto mjete? Por edhe sikur të mbesin, a e keni idenë sa pak janë për ta bërë gjithë atë punë që nevojitet të bëhet? Kjo është një shenjë e qartë e mungesës së seriozitetit në planifikimin dhe zbatimin e projekteve infrastrukturore.

533 mijë euro janë paraparë të destinohen për ndërtim të fushave për futboll të madh në Sazi, Saraishtë dhe Dardani. Edhe për vitin aktual, sipas KAB-it të vitit të kaluar ka pasur mjete të ndara për këtë projekt. Njëjtë është bartur edhe për vitin e ardhshëm ndërkaq këto fshatra mbesin krejt njëjtë e këto para mbesin vetëm si numra në letër. Por, skandalet nuk përfundojnë me kaq. Paramendojeni, në Kornizë Afatmesme Buxhetore, aty ku i kanë paraparë t'i ndajnë plot 600 mijë euro të qytetarëve, e kanë shkruar "rregullimi i rrjetit të dëmtuar të kanalizimit në fshatrat Dardani, Greme, Mirosalë, Zllatar, ETJ".

Pra, kjo është qeverisje e "tahunit". Qeverisje me të rrokne. Veç kur ta shohim në premtimet e radhës "premtimet në koftë kismet do t'i kryejmë brenda mandatit. Mos koftë kismet, ka qenë kismet i përmbaruesit dhe i atyre të afërmeve që përfitojnë vazhdimisht nga Komuna sepse e ndajnë profitin me këta që ua sigurojnë".

Çështje tjetër kritike është edhe sektori i bujqësisë. Në tri vitet e ardhshme janë paraparë të ndahen afro 2.7 milionë euro për bujqësinë. Megjithatë, për asnjë nga këto fonde nuk ka destinime konkrete dhe parashikime të detajizuara.

Nuk dihet se ku do të bëhet hapja e kanaleve kulluese për tokat bujqësore. Kjo është thelbësore për rritjen e produktivitetit bujqësor dhe parandalimin e përmytjeve. Po ashtu, nuk ka asnjë informacion se ku do të ndërtohen silloset për ruajtjen e grurit, një komponent kyç për sigurimin e ushqimit dhe stabilitetin e çmimeve.

Gjithashtu, mungon informacioni se ku do të bëhet qendra e panairëve, një element i rëndësishëm për promovimin e produkteve vendore dhe ndihmën për fermerët që të tregtojnë produktet e tyre, mirëpo paratë janë shkruar në KAB. Po ashtu, nuk ka asnjë plan për rregullimin e arave me zhavor, një investim i domosdoshëm për përmirësimin e infrastrukturës bujqësore.

Në mënyrë të qartë, 2.7 milionë euro janë planifikuar për bujqësinë pa asnjë strategji të qartë dhe të detajuar. Kjo është e papranueshme dhe tregon një mungesë serioziteti dhe përgjegjësie në menaxhimin e fondeve publike.

Këto fonde pra janë lënë në gjendje të paqartë dhe të paplanifikuar, siç thotë populli, "për rrush e kumbulla ku të ka nevojë!" Qytetarët dhe fermerët tanë meritojnë më shumë.

Më tej, parashikimi i vetëm 250,000 euro për ndërtimin e tregut të kafshëve dhe strehimoren e qenve është skandaloz. Ky është një tregues tjetër i qartë i mungesës së vizionit dhe prioriteteve të gabuara të kësaj qeverisje. Një treg i kafshëve është jetik për ekonominë lokale dhe për tregtarët tanë, ndërsa një strehimore e qenve është e domosdoshme për të adresuar problemin e qenve endacakë dhe për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve. Me këto fonde të pamjaftueshme, qeverisja po i lë në baltë qytetarët tanë dhe po i injoron nevojat bazike të qytetarëve.

Kjo Kornizë Afatmesme Buxhetore është shembull flagrant i mungesës së transparencës dhe planifikimit nga ana e qeverisjes aktuale. Nuk kemi specifikime për vendin, kohën apo afatin e realizimit të këtyre projekteve. Kjo tregon një mungesë totale të planifikimit strategjik dhe neglizhencë të plotë për nevojat e qytetarëve kërkesat e të cilëve nuk janë marrë fare për bazë.

Rregullimi i tregut të gjelbër, që sipas kësaj Kornize nuk do të realizohet deri në vitin 2027, është një tjetër dëshmi e qartë e dështimeve të këtij pushteti. Ky projekt ka qenë premtim i kryetarit për t'u realizuar brenda mandatit dhe tani shihet qartë se ky premtim nuk do të mbahet. Qytetarët kanë votuar për këtë qeverisje me besimin se premtimet do të përmbushen, dhe tani po tradhtohen në mënyrën më të pafytyrë të mundshme. Kjo është shkelje e besimit të qytetarëve dhe një dështim i madh i qeverisjes tuaj.

Ajo që është tërësisht e papranueshme për shkak të nivelit të joseriozitetit që e keni është ndërtimi i shtëpisë së pensionistëve me vetëm 90,000 euro të parashikuara për tre vitet e ardhshme.

Ky është shembull i mungesës së respektit ndaj një prej grupeve më të shkelura të shoqërisë sonë, të cilëve nuk po ua ndalni gënjeshttrat. Këta njerëz kanë punuar gjithë jetën e tyre dhe meritojnë më shumë se kaq. Kjo qeverisje po i trajton pensionistët tanë me mungesë dinjiteti, duke i lënë ata në harresë dhe duke iu mohuar shërbimet dhe përkujdesin që meritojnë.

Përfundimisht, kjo Kornizë Afatmesme Buxhetore është reflektim i qartë i mungesës së vizionit, planifikimit dhe përkushtimit nga ana e qeverisjes. Është koha që të ndalet ky abuzim dhe të ketë hapësirë për diskutim e zhvillimi të Komunës sonë dhe për mirëqenie të qytetarëve tanë.

Ju faleminderit për vëmendjen dhe uroj që të reflektojmë seriozisht mbi këto çështje dhe të marrim masa konkrete për të përmirësuar situatën.

Ju faleminderit!

Pas Brahimit Kryesuesi theksoi se fjalën e ka Flamur Istrefi i cili pasi përshëndeti të pranishmit theksoi:

Sot, kemi para nesh Kornizen Afatmesme Buxhetore 2025/2027, dokument i cili pasqyron caqet e Përgjithshme të hyrave dhe shpenzimeve, si dhe orienton projektet kapitale Për tri vitet e ardhshme.

Korniza Afatmesme Buxhetore që na ka ardhur, nga dokumentet kryesore që ky Kuvend duhet ta miratojë, kështu siç është, tregon Për jo seriozitet gjatë hartimit të saj. E them këtë, sepse ne pjesën ku paraqiten 5 shtyllat, që janë bazament i zhvillimit ekonomik dhe social: tek shtylla e 2, të Përmirësimit të shëndetit publik dhe mirëqenies së qytetarëve thuhet: Vazhdim i menaxhimit të pandemisë Natyrisht lind Pyetja: Për cilën pandemi e keni fjalën kryetar? Sa Për informate pandemia e Covid 19 edhe zyrtarisht, në Kosovë ka marrë fund vitin e kaluar. Prandaj, kjo tregon që t'i kryetar, drejtoret e tu por edhe kuvendaret nga subjekti yt, dokumentet që vet i propozoni, as nuk i shikoni paraprakisht.

Njejte eshte edhe te shtylla e trete, ku te Përmiresimi i Ambientit te komunes dhe qendrueshmeria e tij: e keni paraqitur Parkun te Gjon Sereqi.

Si eshte e mundur qe, edhe në kete kornize Përseri e keni futur kete park, e ne anen tjeter nuk e keni te projektet kapitale. Kryetar, ju e dini qe nuk mund ta beni kete park, prandaj as nuk e planifikoni. Ju edhe nje rruge qe keni dasht me hap te Gjon Serreqi eshte dasht me i nderpre punimet. Prandaj eshte dashur ta hiqni kete pike nga korniza e mos ta leni vetem sa Për sy e faqe.

Njejte si këto dy raste ka edhe shumë raste te tjera, ku shihet qarte se nuk eshte prekur asnje shkronje nga Kornizat e viteve te kaluara.

Sa i Përket te hyrave vetanake, eshte interesant fakti se në KAB 2024/2026 ishte vleresuar qe në vitin 2025 te kemi te hyra rreth 5.6 milion Euro, ndersa në kete kornize eshte planifikuar rreth 8 milion. Pra, 2.4 milion Euro me shume.

Ajo qe bjen në sy me se shumti eshte qe tatimi ne pronë ka renie nga 3.3 milion sa ka qene e vleresuar ne 2 milion e 946 mije euro. Qe i bjen 350 mije euro me pak.

Rritja kryesore e te hyrave vetanake do te ndodh Tek qertifikatat dhe dokumentet zyrtare 70 mije euro Te hyra qe kane qene në vitin 2024, tani me kete kornize planifikohen te arrihen 150 mije euro. Pra dyfishim. Kete logjike Se si do ta arrijne kete rritje nuk e di, por duhet me theksu faktin se tashme eshte edhe platforma Ekosova e cila eshte Pa pagese për certifikate e Dokumente tjera familjare edhe e cila besoj qe do ndikoj qe Te hyrat Te ulen e jo te dyfishohen. Situate e njejte eshte edhe tek te hyrat tjera, si me taksat për legalizimin e pronës ku nga 220 mije planifikohen 424 mije euro,nga bashke pagesat për Arsim nga 80 mije në 150 mije si dhe Te hyrat nga lejet për ndertesa nga 691 mije euro trefishohen ne 2 milion euro. Ky planifikim i rritjes se te hyrave në kete forme paushalle, Për mua eshte veshtire i realizueshem dhe si i tille i rrezikon edhe projektet kapitale qe jane planifikuar.

Tek shpenzimet

Përveç pagave dhe medetjeve si Kategoria kryesore me 45.57%, rritjen kryesore e kane Mallrat dhe Sherbimet ku nga 8 milion sa kane qene, Për vitin e ardhshem jane planifikuar 10 milion e 250 mije euro. Nderkohe qe shpenzimet kapitale edhe pse eshte trumbetuar ne vitet e kaluara se do te kete rritje për këtë kategori, ato jane zvogeluar krahasuar me vleresimet e KAB 2024/2026. Nga 12 milion e 670 mije euro sa ka qene e vleresuar për Vitin 2025, tashme jane planifikuar 12 milion e 100 mije euro. Pra 570 mije euro me pak. Pra i po i rrritim te hyrat vetanake Për 2.4 milion, duke e renduar gjepin e qytetarev e ne anen tjeter po e zvogelojme shumen Për projekte kapitale nga te cilat Përfitojne drejtePërdrejte qytetaret.

Sa i përket projekteve kapitale për tri vitet e ardhshme, është situate e njejte qe shumë vite, e cila nuk ndryshon. Janë projekte të njehta, gjë te cilen e kam thënë edhe vitin e kaluar, Se disa projekte i fillon, projekte të cilat në të shumtën e rasteve nuk i mjaftojnë as dy mandate për t'i përfunduar, jane disa projekte të tjera, të cilat asnjeherë nuk fillohen si dhe disa te tjera Për te cilat ka pas fjale te medha e tashme ka hequr dore prej tyre.

Projekte te cilat kanë filluar e shtyhen çdo vit janë:

1. Ndërtimi i stacionit te ri te Autobusëve (edhe dy vite)
2. Ndërtimi i tregut të gjelbër (është shtyre edhe për një vit, pra deri në 2027, tri vite)

3. Rregullimi i tregut të kafshëve dhe Ndërtimi i strehimores Se qenve, Projekt i cili është dashur Te Përfundoj në vitin 2024, e ke shtyre edhe për dy vite, deri në vitin 2026, si dhe
4. Ndërtimi i objektit II Për nevoja të komunes në fsh. Gerlice.

Projekte të cilat janë futur në vazhdimësi në Kornizë Afatmesme Buxhetore e asnjehere nuk janë realizuar, Janë:

1. Ndërtimi i shtëpisë së pensionistëve
2. Ndërtimi i QMF-se në Koshare
3. Ndërtimi i fushës për futboll të madh në Dardani si dhe
4. Ndërtimi i Qendres rehabilituese për përdoruesit e substancave narkotike etj

Projektet për të cilat kryetari Aliu ka thënë fjale të mëdha në fillim, e që ka hequr dorë nga to janë:

1. Ndërtimi i objektit të Ri të komunes, të cilin në vitet e kaluara e ka pas të planifikuar edhe në buxhet
2. Parkun të Gjon Serreqi
3. Qerdhet në Komogllave, Nerodime dhe Dardani
4. Ndërkohë që ka hequr dorë edhe nga Ndërtimi i shkollës së Re në Varosh, të cilën e ka pasur në buxhet Për vitin 2025, e tashmë nuk është

Për projektet të cilat nuk përfundojnë, për ato që nuk fillojnë, edhe për ato që ka hequr dorë vet kryetari Ali, ai gjithmonë e gjen një arsye. Here e ka fajin ish qeverisja komunale e para 8 viteve, here niveli qendror, here kontrata kolektive. Asnjë here ky nuk është fajtor. Edhe atëhere kur i ngriten aktakuza bashkë punëtorëve të tij që i ka në qeverisje Për keqpërdorim detyrë, ky ska faj, distancohet. Edhe atëhere kur behet publike që asfalti i shtruar në fshatin Mirash, nuk është aty ku duhet ky Përseri zgjedh heshtjen se ska faj, edhe atëhere kur jepen tender me negocim në vlerë qindra mijera Euro ky është pa faj. Kryetari Aliu ka treguar që është kampion i justifikimeve për deshtimet dhe mos punën e qeverisjes së tij

Prandaj, Projektet që sot i kemi para ne, të cilat Që shumë vite Po zvarriten, besoj që Përseri një numër i tyre nuk do të realizohen në kohën të cilën janë planifikuar, dhe pjesa tjetër nuk do të realizohet fare , kështu që si pasoje e keqmenaxhimit dhe keqplanifikimit.

Besim Haziri - Pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se Kryetar do të flas për parqet e gjelbërta për të cilat edhe në fushatë, e tani më nuk e kemi as pjesë të projekteve, bëhet fjalë për parkun të spitalit, parkun të “Gjon Sereqi” dhe derisa të vetmin park që e ka planifikuar dhe i cili as ai nuk do të bëhet, është të parkun të “Pastërtia” dhe ai është i kryqëzuar nga projekti i ri që do të bëhet pra edhe ai park besojmë që nuk do të bëhet dhe atë veç zoti e di kur të do të bëhet ky objekt, kryetari u thirrë shumë në afëra gjelbëruese për atë që u thirrë ky projekt të gjelbërta d.m.th asnjë nuk do të bëhet kryetar, besoj që në mandatin tjetër vjen LDK dhe i bënë këto.

Arian Imeri - Pasi përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se paravetës kemi KAB-in i cili është një parashikim se si do të jetë edhe buxheti i ardhshëm për atë edhe ky dokument është në parim dhe nuk ka vend për kritikë por do të duhet të ketë propozime të reja dhe të presim për miratimin

e buxhetit, nga ajo që shihet është që parashikohet një rritje prej 5 milion euro dhe e cila është një rritje në bazë të ligjit dhe e cila do të ndihmoj fusha të ndryshme si zhvillim ekonomik, arsim e gjithqka tjetër.

Parashikimi përfshijnë 3 vite dhe kjo besojë që do të pësojnë rritje sipas asaj që di vetëm Prishtina dhe Ferizaji, ka rritje në regjistrimin e fundit të popullësisë dhe kjo rritje e buxhetit nuk ndodhë rastësisht, prandaj nuk është mirë edhe shumë me kritiku në të thatë sepse faktet nuk përputhen, duhet patur parasysh që Ferizajn e shohin me prespektivë edhe qytetarët e vendeve tjera për këtë arsye edhe ka rritje këtu.

Verona Isaku

Faleminderit kryesues
Përshendetje për të gjithë

Kryetar e vetmja e mire e pushtetit tënd dhe paraqitjen tende është që arrin me na mbledh drejtorat në séance, e për këtë të përgezohë për vullnetin që e ke.

E dyta, KAB-in e ke reprisë bajate, i njejtë është edhe fjalimi yt, më dukete keni një folder në zyrën tënde dhe vetëm ia nderroni vitet KAB-it, përndryshe e keni të njejtin fjalim, të njejtat pika, asgjë nuk ndryshoni.

Po ndalem të te hyrat vetanake, pra për planifikim e te hyrave vetanake, keni parapa që për certifikata dhe dokumente të tjera do të rritet dyfish shifra e te hyrave, e deshta me ju pyet se qysh doni me ja ba, nuk e di a e dini pse ekziston platforma e-kosova, në të cilën mund të kryhen të gjitha keto shërbime, zyre të vendit me nuk ke në mënyrë që me u shpërnda turma e njerezve, pra me nuk vjen askush në komune por keto shërbime i kryen në e-kosova, pra vetëm nese e keni rrit tarifen ose taksen për leshimin e një certificate se ndryshe nuk ka ndonjë logjikë të kete kete rritje.

Tjetra, drejtori yt vazhdimisht prononcohet që nuk ka me leje të ndertimit, që janë pakesuar ato, mirëpo nga 700,000.00 euro ju planifikoni që kjo vlerë të shkojë në 2 milion, pra ka rritje prej 1 milion e 300 mijë.

Rritje të dyfishtë planifikon edhe në mjete gjeodezike dhe taksa të pajisjeve motorike, pra unë vetëm dua ta di qysh po planifikon me arrit qëllimin që ia keni vendos vetes, në mënyrë që kur vitin tjetër të vije prap KAB-i në kuvend, kur prap do të ju deshtojnë projektet, mos me nis e me u anku.

Ismajl Sejdiu - Pasi përshëndeti të pranishmit unë mëndo që në këtë KAB që të përfshihet para 25 vjetorit për lapidarian e Jezercit dhe nuk kërkojmë që të parashihet ndonjë shumë e madhe mirëpo mëndo që është momenti që të përfshihet në këtë kornzië edhe ajo çështje duket pasur parasysh historinë e Jezercit, besojë që do të ketë edhe një përfshirje nga opozita për këtë çështje ju faleminderit.

Shqipe Jashari - Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, theksoi se unë do kërkoja disa sqarime rreth disa qendrave p.sh. për mbrojtjen e fëmis, kisha dashtë të di se ku sakt janë këto dhe në dim që e vetmja shtëpi për mbrojtjen e fëmis ka qenë në Prishtinë dhe ajo u mbyllë, ndërsa për

përsona të moshuar ku do të shkojnë këto mjete, kjo kornizë është e mangët p.sh rregullimit të QMF-së 4, është në gjendje të tmerrshme në tualete ku as nuk hyhen në to e vetmja investim që është ba aty janë vendosja e klimave të cilat edhe ashtu kanë qenë të pa nevojshme, për financim të qerdhes në Fshatin Greme asnjë nuk është e finalizuar pasi ka inventar të shkatërruar, transporti nga qendrat në shtëpi apo anasjelltas nuk janë të përfshira, kryetari përmendi nënat vetëushqyese, a kishe mujt mëm tregu çka ju ke ndihmu, ku vetëm në ndonjë festë ju ipen ndonjë pako me ushqim a qekjo është ndihmë a, ju faleminderit.

Sadat Ismajli - Pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se nuk e pash një debat productive, e para sa herë bisedohet thuhet keq përdorime, sa herë që keni këso të tilla qoni aty ku o vendi, po ju sqaroj një çështje rreth Qerdhes të Fshatit Komogllavë, qeveria e ka marrë përsipër atë me rregullu, ju e përmendët edhe parkun të spitali, ju e dini që pa u ndreq spitali nuk mundet mu ba ajo sakt, e dini ju që është më e mira ma shumë mu fokusu me ardhe me projekte, mirëpo ju asnjë projekt se keni prurë veç po predikoni, nuk po besojë që janë tu shit ma këto.

Ejup Delolli - Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, unë e kom analizu qet raport financiar një sen duhet me pranë, qe për se u punu në qytet, u punu për që ka nevojë me u ba ma mire, sigurisht që ka, a kem mundësi na me kontribu ma shumë?, sigurisht që mudemi, një sen që mu po më pengon te kjo është këtu kryetar, uje duhet me pas ma shumë, kryetar një sen tjetër është Palestra sportive në Zaskok, shkolla është e mire, po mirë është me ba, është mirë me kanë ma specifice, pak te disa p.sh. të fushat sportive ku kanë mu ba, më ka thanë që po kryhet, po këtu apert nuk janë të përcaktuara edhe një sen tjetër është që kom kërkim edhe qasje në dokumente zyrtare, mirë o mi hulumtu aty ku ka dyshime edhe jo veq me fol me ba amulli, një sen që du me potencu është që sa herë që kërkojmë te drejtoret ata japin info, ju faleminderit.

Amir Rexhepi - Pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se me nxitën koleget e pozitës pasi fjalimet e tyre ishin madhështore, po propozime konkrete s'kemi uje të pishëm p.sh. fshati ku unë vijë s'ka dhe të gjitha ato fshatra nga vijë unë, Drejtoria i infrastrukturës koka këtu p.sh. Fshati Koshare ku lidhet me Fshatin Slivovë, aty ska trotuarë, është mirë me u mire me të, pasi aty shkojnë fëmijët në shkollë dhe është rreziku, ku rrezikohet me fatalitet aty tjetër banorët e Fshatit Slivovë s'kan park, ndonëse kanë hapsirë të madhe, te Drejtoria e Arsimit shkollat tona nuk kanë kabintete të mirëfillta dhe do të kishte ndiku pozitivisht në arsim.

Mimoza Pajaziti - Pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se dua ta jap një propozim konkret p.sh. të finalizohet ujësjells në fshatra, ndërsa në ato hapsira ku janë fushat sportive të jenë për të rriturit edhe për fëmijë, ku janë të parapara edhe për shëndetin mendor e fizik, ju përgëzojë kryetar për këto projekte.

Elbasan Osmani - Pasi përshëndeti të pranishmit realisht unë kam prit që ky debat të jetë më përmbajtësor më konkret, unë konsideroj që është një dokument voluminoz dhe gjithëpërfshirës, megjithëse do të ketë edhe projekte që nuk mund të jenë të gjitha të përfshira, për shkak të mundësive buxhetore, nga kolegët opozitar s'kanë diçka konkrete, kanë vetëm pyetje, kanë vetëm kritika, që janë jashtë teme, e kështu me radhë.

Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi - Pasi pyeti nëse ka tjerë për këtë temë dhe pasi nuk pati tjerë të interesuar ai e mbylli këtë pikë dhe e hodhi në votim dhe kaloi me 22 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi - Lexoi pikën e 5-të dhe pasi spati të interesuar për diskutim kaloi me 22 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi - Lexoi pikën e 6-të dhe ia kaloi fjalën Arbër Bytyqit, i cili theksoi se kemi obligim ligjor që të fillojmë me të gjitha procedurat për PZHK dhe ju ftoj që të japim dritën e gjelbërt për të filluar procedurat fillestare për këtë çështje dhe pasi spati të interesuar për diskutim kaloi me 22 vota për, 0 kundër, 0 abtenim.

Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi - Lexoi pikën e 7-të dhe ia kaloi fjalën drejtorit i cili theksoi se këto ndryshime kanë ardhur si pasojë që një anëtarë është punësu dikun dhe ndryshimet tjera në detaje i keni në propozim, andaj ju ftoj që ta votoni për të mos humbur kohë.

Faik Selmani - Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit duhet patur parasysh që prej javes tjetër fillojmë me vendosjen e nr. dhe duhet patur parasysh që ferizajt ju ka dhan prioritet pasi i ka kry punët në afat record, mirëpo unë kam kërku që të shtyhet edhe për një javë për shkak të asaj voneses që kemi pas.

Flamur Istrefi - Pasi përshëndeti, drejtor komisioni i kaluar është propozu nga ju, tash a kanë qelë me konkurs apo nga ju pasi nuk ka mundësi me u dorëheç menjëherë, pas një muaji pasi nuk ka mundësi kështu mund të ndodhë që edhe këta të japin dorëheqje.

Arbër Bytyqi - Theksoi se kemi zgjedhur kritere të përvojës dhe kritere ligjore ne jemi munduar që të bëjmë zgjidhje sa më të shpejt edhe nese dikush nga këta jep dorëheqje do ta sjellim plotësimin menjëherë.

Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi - Pasi nuk ka tjerë për të diskutuar e hodhi në votim dhe kaloi me 21 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Pyetje dhe kërkesa:

Verona Isaku
Faleminderit kryesues

Kërkesa ime është për Drejtorin e shërbimeve publike, i cili duhet te intervenojë në mënyrë urgjente në Rrugën “Bajram dhe Gursel Sylejmani” përkatësisht tek “Berisha Petrol”. Ne kete rruge duhet te vendosen trapat në rrugë pasi qe vazhdimisht po bëhen aksidente, vetëm javën e kaluar brenda tri dite janë bërë tre aksidente, fatmirësisht me dëme materiale, mirëpo qe duhet te intervenohet menjëherë, në mënyrë qe shofereve te pandërgjegjshëm te ju pamundësohet lëvizja e veturave me shpejtësi të madhe.


Gjithashtu kam edhe një kërkesë për Kryesuesin e kuvendit Xhavit Zariqi. Kryesues, mendoj se ka ardhur koha qe t'i kërkoj falje këtij kuvendi, anëtareve të opozitës, ndaj te cilëve ke sulme dhe ofendime të njëpasnjëshme. Ne ndoshta edhe nuk dimë, ndoshta nuk kemi haber për qfarë po

flasim, mirëpo ju nuk e keni te drejtën te na ofendoni me gjuhën që nuk ju takon. Ne rast se e keni te pamundur te menagjoni seancën, atëherë jep dorëheqje, votojmë një kryesues te ri i cili mund te menagjoj më mirë.

Flamur Istrefi - Unë dola thjesht me i dhanë mbështetje Veronës pavarësisht sjelljes sonë, edhe Kryetari i komunës nuk duhet ta zgjedhë rolin e heshtjes një çështje duhet patur parasysh para çdo seance te KAB-it të buxhetit, është një sjellje e njëjtë ofenduese nga ju d.m.th. para se me marrë fjalën kryesuesi, ju e merrni dhe duke ofenduar e prishni seancën, ne s'jemi këtu për të bërë debat me ju, ju jeni një nga ne, nëse do me marrë fjalën del e merr në foltore si asamblistë. Nuk ka nevojë ne me lëshu sallën si sot, mirëpo s'mund të qëndrojmë kur ju përdorni këso fjalë.

Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi - Asnjë ofendim se kam ba, veç ka me ju tregu kush jeni e çka po bani, a ka dikush diçka në të ndryshme mbasi nuk paska, me kaq e shpalli te mbyllur këtë seancë.

Procesmbajtësi



Leutrim Mahmuti

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi